

• **25 VENDE TË LIRA PËR PUNONJËS NËNOFICER**

I. KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT PËR NËNOFICER:

- ✓ Të jenë të moshës deri 30 vjeç
- ✓ Të kenë përfunduar arsimin e mesëm;
- ✓ Të mos jenë dënuar penalisht;
- ✓ Të kenë sjellje të mira qytetare;
- ✓ Të jenë të aftë fizikisht dhe me gjatësi jo më të vogël se 1,75 m.
- ✓ Të pranojnë nënshkrimin e kontratës

II. DOKUMENTAT QË DUHET TË PARAQESIN KANDIDATËT

Aplikantët duhet të paraqesin në fazën e parë të konkurrimit dokumentat e mëposhtëm:

1. Kërkesë
2. CV (Kurikulum vitae)
3. Kopje të kartës së identitetit
4. Dëftesën e shkollës së mesme ose listë notash, **të cikluar** në Drejtorinë Arsimore të Rrethit, **të fotokopjuar dhe të noterizuar**.
5. Vërtetim nga Gjykata
6. Vërtetim nga Prokuroria
7. Raport i aftësisë në punë (sipas shtojcës V, të VKM nr.596, datë 4.9.2019), nga mjeku i familjes.
8. Dëshmi për kuafikimet e kryera (nëqoftëse ka)
9. Deklaratë personale mbi pastërtinë e figurës (Plotësohet kur aplikanti paraqitet për testim)
10. Dy foto të printuara (9 X 12) me kostum dhe kollare (fotot të dorëzohen edhe me CD).

Dokumentat do të dërgohen me postë në adresën: Garda e Republikës, Rruga e Elbasanit, Pallati i Brigadave, Tiranë, **brenda datës 20.06.2020.**

III. TESTIMI I KANDIDATËVE

Kandidatët duhet të paraqiten **në orën 9⁰⁰ të datës 29.06.2020**, në adresën: Qendra e Formimit dhe Kualifikimit Profesional, të Gardës së Republikës, Mullet, Tiranë, **të veshur me uniformë sportive dhe atlete.**

Kandidatët do t'i nënshtrohen testimit në tre faza:

- Intervista
- Vlerësim i aftësive shëndetësore
- Testim i aftësive fizike

Vlerësimi i aftësive fizike do të bëhet në bazë të komponentëve të mëposhtëm:

TABELA
E TESTEVE TË PËRGATITJES FIZIKE
MOSHA 21 – 29 VJEÇ

Nr	ELEMENTËT TESTUES	PËR SASINË/ KOHEN		PIKËT	VLERËSIMI
		Meshkuj	Femra		
1	Ulje – ngritje me forcën e krahëve (pompa) për kohën 2’.	60	30	25	Shkëlqyeshëm
		57	27	23	Shumë mirë
		55	25	20	Mirë
		52	22	17	Kënaqshëm
		50	20	15	Mjaftueshëm
		47	17	13	Minimal
		nën 47	nën 17	10	Dobët
2	Palosje – shpalosje me muskujt e barkut për kohën 2’.	60	30	25	Shkëlqyeshëm
		57	27	23	Shumë mirë
		55	25	20	Mirë
		52	22	17	Kënaqshëm
		50	20	15	Mjaftueshëm
		47	17	13	Minimal
		nën 47	nën 17	10	Dobët
3	Tërheqje në hekur	16	8	25	Shkëlqyeshëm
		15	7	23	Shumë mirë
		14	6	20	Mirë
		13	5	18	Kënaqshëm
		12	4	15	Mjaftueshëm
		11	3	13	Minimal
		nën 11	nën 3	10	Dobët
4	Vrapim rezistence 3000 m me uniform sportive.	13’	16’	25	Shkëlqyeshëm
		13’ 15’’	17’	23	Shumë mirë
		13’ 30’’	17’30	20	Mirë
		13’ 50’’	18’	17	Kënaqshëm
		14’	18’ 30’’	15	Mjaftueshëm
		14’ 30’’	19’	13	Minimal
		mbi 14’ 30’’	mbi 19’	10	Dobët

IV. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Vlerësimi i përgjithshëm:

Me 100 pikë Shumë mirë
Me 90 pikë Mirë
Me 80 pikë Mjaftueshëm
Nën 80 pikë Dobët

Kandidatët aplikues që të kualifikohen në fazën e parë dhe të pranohen për të vazhduar konkurrimin në fazën e dytë duhet që në testimin fizik bazë të arrijnë rezultatin minimal 80 pikë.

KOMUNIKIMI I REZULTATEVE TË KONKURRIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, të gjithë kandidatët fitues në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike (e-mail personal) ose me telefon nga Garda e Republikës.